




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit nr.03-L-48 për Menaxhimin e financave Publike dhe Përgjegjësitë, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 49 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 26.11.2012 miratoi këtë:

VENDIM

Për lejimin e transferit dhe harmonizimit të mjeteve financiare

I

Me këtë vendim lejohet transferimi dhe harmonizimi i një pjese të mjeteve financiare brenda organizatës buxhetore nëpër programe buxhetore për mbulimin e minusit të pagave për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2012.

II

Mjetet financiare për mbulimin e minusit të pagave do të merren nga programet të cilat kanë teprice të mjeteve, dhe do të transferohen dhe harmonizohen në programet të cilat kanë mungesë të mjeteve financiare.

III

Transeferi dhe harmonizimi i mjeteve financiare bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03-L-48 për Menaxhimin e financave Publike dhe Përgjegjësitë.

IV

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-131116
Gjilan, më 26.11.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues